

Jupë HOTI
Prishtinë

KONFISKIMI I PASURIVE TË SHQIPTARËVE NGA MALISHEVA ME RRETHINË 1945-1946 TË SHPALLUR ARMIQ TË SHTETIT JUGOSLLAV

Materiale

Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore si dhe fitores së Bllokut Socialist nën udhëheqjen e BRSS-së, në Kosovë u instalua pushteti i ri jugosllav (Jugosllavia e Titos). Pushtuesit e rinj, të cilët erdhën me ndihmën e të ashtuquajturve “Komunistë Shqiptarë të Kosovës dhe Shqipërisë” dhe me propagandën e tyre se pushteti i ri do t’ia njohë të gjitha të drejtat popullit shqiptar në Jugosllavinë e re, duke iu premtuar se me përfundimin e LNÇ-së do të respektohet e drejta e popujve për vetëvendosje dhe se shqiptarët e Kosovës do të kenë të drejtë të vendosin për fatin e tyre, nëse dëshirojnë të jetojnë nën Jugosllavi apo të bashkohen me shtetin amë Shqipërinë.

Konferenca e Bujanit, e cila i zhvilloi punimet më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar të vitit 1944, në Malësinë e Gjakovës, e në të cilën morën pjesë 49 delegatë, ku 42 prej tyre ishin shqiptarë dhe 7 serbë e malazez. Në Rezolutën e nxjerrë nga kjo konferencë, ndër të tjera, thuhet: “Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipërinë” e se rruga që duhej ndjekur për të realizuar aspiratat kombëtare të popullit të Kosovës është

angazhimi në luftën e përbashkët me popujt e tjerë kundër pushtuesit nazist.¹

Kjo propagandë e udhëheqësve serbo-jugosllavë nuk zgjati shumë, ngase menjëherë, me vendosjen e shtabeve të njësiteve partizano-çetnike në rajonin e Kosovës, filluan edhe ndeshjet e para ushtarake me formacionet e Ballit Kombëtar dhe Partisë Nacional Demokratike Shqiptare të udhëhequr nga prof. Ymer Berisha, si dhe me brigadën e tribunit popullor “Shaban Polluzha” në Drenicë. E provokuar për t’u ngritur në revoltë, pastaj e trajtuar armiqësisht, e terrorizuar egërsisht dhe e vënë në administrim ushtarak nga 8 shkurti deri më 5 korrik 1945, Kosova nga fundi i Luftës së Dytë Botërore u ndodh në një situatë tepër të rëndë. Në shkurt të vitit 1945, kur forumi i lartë i Partisë Komuniste Jugosllave vendosi që Kosova t’i aneksohej Serbisë, asaj iu mohua statusi i Republikës dhe u konsiderua Qark Autonom i Serbisë.² Kuvendi i Prizrenit i mbajtur me 8-10 korrik 1945 nga Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar i Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit, ku shumica e pjesëmarrësve ishin serbë e malazez, të cilët ishin të rrethuar nga njerëz të sigurimit shtetëror jugosllav miratoi formalisht një rezolutë të ardhur e të përgatitur nga Beogradi. Në të thuhej se shprehej dëshira e popullit të Kosovës për t’iu bashkangjitur Serbisë.³

Në gusht të vitit 1945, vendimi i Prizrenit u sanksionua në Mbledhjen e Tretë të Këshillit Antifashist të Jugosllavisë. Të gjitha këto vendime me vete bartën edhe vendosjen e një klase politike projugosllave në skenën politike në Kosovë, në Maqedoni dhe në viset e tjera të banuara me shqiptarë.⁴ Me këtë status shqiptarëve iu mohuan një varg të drejtash edhe ato më elementare. Grupin më të fuqishëm shqiptar e përbënin ballistët. Politikisht, rezistenca ishte bashkuar në Organizatë Nacional Demokratike Shqiptare, e cila u themelua në vitin 1945.⁵

¹ Grup Autorësh, *Histori e Popullit Shqiptar IV*, 1939-1990, Toena, Tiranë. 2006, f.143.

² Maringlen Verli. *Shqipëria dhe Kosova Historia e një aspirate vëllimi i dytë*, Impex, Tiranë 2007, f.302.

³ Grup Autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar IV* 1939-1990, Toena, Tiranë, 2006, f. 342.

⁴ Ethem Çeku, *Shekulli i Ilegalës*, Prishtinë, 2004, f. 27.

⁵ Oliver Jeans Schmit, *Kosova një histori e shkurtër e një treve ballakanike*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 172.

Prej nëntorit të vitit 1944 e deri në maj 1945 njësitë komuniste luftuan kundër kryengritjes shqiptare në vatrat tradicionale të rezistencës, që ishin Drenica, Llapusha dhe Dukagjini.⁶ Tanimë, gjatë kësaj periudhe, u ashpërsuan edhe sulmet ushtarake e policore kundër formacioneve të Ballit Kombëtar, Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, e Besës Kombëtare në Kosovës. Në saje të këtij përcaktimi nacionalistët shqiptarë nuk e kishin armik të vetëm shtetin jugosllav, por edhe ata shqiptarë, të cilët do të luftojnë bashkërisht për likuidimin e udhëheqësve të këtyre organizatave si dhe njësive të saj të strukturuar nëpër pjesë të ndryshme në Kosovë dhe Maqedoni.⁷

Kështu, nga viti 1945 e deri në vitin 1947, Beogradi dhe Tirana do të persekutojnë, burgosin dhe vrasin me qindra aktivistë dhe anëtarë të kësaj organizate.⁸ Dhuna e terrori mbi popullsinë shqiptare arritën kulmin, luftonin grupet e armatosura anekënd Kosovës, por luftimet më të ashpra zhvilloheshin në Drenicë e Llapushë nga forcat e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare dhe Besës Kombëtare, të udhëhequra nga prof. Ymer Berisha e Ukë Sadiku. Pothuajse i tërë rrethi i Rahovecit kishte grupe luftëtarësh të lirisë, por territori gjeostrategjik i Llapushës ishte më i përshtatshëm për rezistencë, ku dalloheshin çetat e Ukë e Shaban Sadikut nga Gjurgjeviku, Qazim Bajraktarit nga Astrazupi, Alush Smailit nga Llazica, Mustafë Ibishit që vepronin në malet e Zatriqit, Garaçevës, Shkozës, Gajrakut, Bllacës, bjeshkët e Javorit e Berishës e duke depërtuar nëpër malet e Banjës, Senikut, Lladrocit, Carrallukës në malet Llazicës e Negrocit, Plloqices, Gllarevës, ku lidheshin me fshatrat e Drenicës dhe Dukagjinit. Çeta këto të cilat luftuan me mjaft heroizëm në mbroitje të atdheut. Luftime të përgjakshme u zhvilluan në fshatin Senik, në malet e Garaçevës, në malet e Gjergjicës, te Çelia e Jellocit, në Sferkë të Gashit etj.

Me rëndësi të veçantë historike ishte edhe Kuvendi i Doberdolit 4-5 gusht të vitit 1945,

⁶ *Po aty.*

⁷ Jusuf Buxhovi, *Kosova, nga Konferenca e Londrës deri te pretektorati ndërkombëtar*, Prishtinë, 2012, f. 309.

⁸ *Po aty.*

i udhëhequr nga Prof. Ymer Berisha, si dhe Ukë e Shaban Sadiku nga Gjurgjeviku, Ndue Përlleshi, Marie Shllaku etj., ku merrnin pjesë përfaqësues të Ballit Kombëtar dhe PNDSH-së nga vise të ndryshme të Kosovës.

Në të vërtetë, veprimet konkrete për degradimin e subjektit politiko-ushtarak në Kosovë filluan menjëherë pas mbledhjes së Bujanit. Këtë e dëshmon letra e Komitetit Qendror të PKJ, e datës 28 mars 1944, përmes së cilës hidheshin poshtë vendimet historike të Mbledhjes së Parë të Këshillit Nacional Çlirimtar për Kosovë e Metohi, veçanërisht pika e 8, në të cilën shprehej vullneti dhe e drejta e popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje dhe bashkim me vendin amë.⁹

Pas vendosjes se pushtetit jugosllav, në nëntor të vitit 1944, në krye të Ministrisë së Bujqësisë erdhi hartuesi i elaboreteve famëkeqe kundër shqiptarëve, Vasa Çubrilloviq.¹⁰

*Më 5 janar 1945 Vasa Çubrilloviq me projektin e ri "Pakicat në Jugosllavi" përpiloi programin për likuidimin e shqiptarëve.*¹¹ Në këtë frymë, më 23 janar të vitit 1945, nga zyra e sigurimit shtetëror jugosllav, për Kosovë ishte lëshuar urdhri për ndjekjen masive të shqiptarëve, e sidomos të atyre që kishin autoritet në popull.¹² Formë tjetër e dhunës ishte konfiskimi i pasurisë së të gjithë atyre që konsideroheshin kundërshtarë të pushtetit.

Në 43 fshatrat e Komunës së Malishevës u konsideruan shumë të tillë e përgjithësisht në territorin e Llapushës, krahinë e cila përbëhej prej 56 fshatrave. *Kurse Komisioni Shtetëror për krime të luftës së Jugosllavisë më 9. XII. 1944 njoftoi Këshillin Popullor të Kosovës për vendimet e AVNOJ-t, që pasuria e okupatorit dhe bashkëpuntorëve të tij kalon në pronësi të shtetit në bazë të nenit 4, alineja 2 të Rregullorës*

⁹ Izber Hoti, *Ngritja dhe rënia e mëvetësisë së Kosovës (1937-1945)*. Instituti i Historisë, Kosova, nr. 18/19, Prishtinë, f. 164.

¹⁰ Maringlen Verli, *Reforma Agrare Kolonizuese në Kosovë*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Iliria, Tiranë, 1992, f. 181.

¹¹ Dr. Hakif Bajrami, *Politika pansllaviste serbe në luftë për shfarosjen e shqiptarëve 1836-1999*, Vjetari, nr. XXXI-XXXII, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 2004, f.134

¹² ASHK, *Fond, Krimet nga Lufta e Dytë Botërore, 1941 - 1944*, Dokument Urdhëresë nr.4 e Komisionit Shtetëror për verifikimin e krimeve të okupatorit dhe ndihmësve të tyre, dërguar më 9. XII. 1944 KP të Kosovës (komisionit për krime të luftës) Pushteti i vlerësonte kriminelë ata që angazhoheshin për kauzën kombëtare).

së Komisionit Shtetror për krime të luftës.¹³ Pas përfundimit të Luftës Dytë Botërore, një ndër çështjet e rëndësishme politike si dhe ekonomike në Kosovë ishte rregullimi i reformës agrare dhe zgjidhja e pronësisë mbi tokën. Rol të rëndësishëm kishte revizioni i reformës agrare ndaj shqiptarëve, të cilët ishin edhe ashtu të varfër e të shkatërruar nga lufta.¹⁴

Si rezultat i mospasurisë në vitet 1945-1947, në sferën e prodhim-furnizimit të popullsisë me produkte ushqimore dhe gjëra të tjera të nevojshme ishte kthimi nga eksportet i drithit dhe i produkteve të tjera ushqimore në import të tyre. “*Shkaktarë të një gjendje të pa favorshme për ekonomin e Kosovës ishin: dobësit dhe mosrealizimet në fushatën për grumbullimin e drithërave, goditja deri në paralizim të sektorit privat në prodhimin dhe tregtinë e vogël, shtetëzimi i industrisë, i cili vihej në përdorim me mangësi dhe pa rentabilitetin e nevojshëm.*”¹⁵ Zhvillimi i dobët ekonomik i Krahinës së Kosovës erdhi edhe si pasojë e pajisjes primitive teknike.¹⁶ Ku sipas ligjit të cekur më lart bëri rekuizimin e pasurisë së 40 familjeve të Llapushës, nga ta 17 familje i takojnë fshatrave të Komunës së Malishevës, të tillë u quajtën të gjithë ata që luftuan për Shqipërinë Etnike.

Një komision i tillë u formua edhe nga Kryesia e Këshillit Popullor të Kosovës, në bazë të nenit 9 të Rregullores mbi veprimtarinë e komisionit shtetëror për zbulimin e krimeve të luftës. Komisioni për krime të luftës kishte për detyrë të kërkonte nga gjyqet ushtarake dhe ato civile raporte për gjykimin e “*kriminelëve të luftës dhe armiqve të popullit*” si dhe të dhëna për pasurinë e tundshme dhe të patundshme.¹⁷

¹³ Po aty.

¹⁴ Sulltane Kojqini - Ukaj, *Dhuna e pushtetit jugosllav ndaj shqiptarëve në rrethin e Pejës*, në vitet e para pas LDB, Kosova 31/32, Instituti Historisë, Prishtinë, 2009, f. 149.

¹⁵ Maringlen Verli, *Ekonomia e Kosovës në vargonjën e politikës jugosllave 1945-1990*, Mësonjëtorja e parë, Tiranë, 2000, f.108.

¹⁶ Ali Hadri, *Marrdhënjet agrare dhe lufta e PKJ në Kosovë e Metohi kundër reformes agrare të padrejtë të Jugosllavisë borgjeze*, 1. Marrëdhëniet agrare në Kosovë e Metohi në kohën e Jugosllavisë së vjetër, Përparimi, nr. 9-10, Prishtinë, 1964, f. 590.

¹⁷ Hakif Bajrami, *Politika pansllaviste serbe në luftë për shfarosjen e shqiptarëve 1836-1999*, Vjetar, nr. XXXI-XXXII, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 134.

Konfiskimi i pasurisë deri te pragu i derës së shtëpisë në kohën kur populli ishte tejet i raskapitur nga lufta, zbatohet veçmas ndaj atyre që e kishin luftuar komunizmin dhe pushtetin e ri jugosllav, e që në masë të madhe ishin burgosur, pushkatuar e internuar.

Duke u bazuar në vendimin e Prokurorisë Publike të Kosovës dhe Metohisë nr.konf.1/45 datë 03-07- 1945. Nga Gjykata Ushtarake e Qarkut të Kosovës dhe Metohisë. Paraqesim procesin e parë të grupit të dënuar në Prokurorinë Publike të Prizrenit. Ndër të tjera thuhet se në procesin gjyqësor të zhvilluar në këtë datë morën pjesë shumë qytetarë, të cilët kishin ardhur për të ndjekur nga afër këtë proces gjyqësor. Por edhe grupi i të akuzuarve shqiptarë ishin shumë kokëllartë dhe secili nga ta diskutonte me bindje se kishin luftuar kundër njësiteve partizano-jugosllave në mbrojtje të nderit dhe atdheut dhe kishin luftuar për krijimin e Shqipërisë Etnike. Prokurori Ali Shukria, ndër të tjera, thotë: Njëri nga të akuzuarit kryesor, foli para trupit gjykues mjaft shumë dhe u sollti të akuzuarve në zemrat e tyre disponim edhe pse ishin të akuzuar me dënimet me vdekje. Duke diskutuar, ndër të tjera, vazhdonte nuk ua kemi frikën, luftuam për tokat tona për Shqipërinë Etnike. Kështu u shpreh njëri nga të akuzuarit e grupit të BK dhe PNDSH-ës.

Në përgjigjet e tyre të guximshme, gjatë gjithë gjykimit të tyre, të akuzuarit, pothuajse çdo fjalë e folën me elegancë.

Kështu të akuzuarit, pa marrë parasysh moshën që e patën, krijuan përshtypje para masave të mbledhura në gjykatore se ishte edhe një pjesë e mirë e qytetarëve shqiptarë, që kishin shkuar për ta përcjellë nga afër gjykimin e këtyre intelektualëve dhe luftëtarëve trima, të cilët, pa marrë parasysh se me çfarë aktakuzash u ngarkuan, ishin të vetëdijshëm se luftuan për mbrojtjen e tokave shqiptare kundër forcave partizano-çetnike të Jugosllavisë.¹⁸

Sipas të dhënave të Shtabit të Ushtrisë Nacional Çlirimtare dhe Armatës Popullore për Kosovë, në raportin që mban datën 14.V.1945, del se në rrethin e Rahovecit e të Suharekës, vepronte një grup prej 150-200 vetash, udhëheqës të këtij grupi ishin Qazim Bajraktari nga Astrazupi, Ymer Berisha nga Gjurgjeviku, Mustafë Derguti nga

¹⁸ ASHK, *Fond Prokuroria Publike, Rrethi i Rahovecit*. Kutia nr. 56, vitet 1946-1948. 276

Rahoveci.¹⁹ Kurse numri i përgjithshëm në tërë teritorin e Llapushës pa dyshim ishte shumë më i madh. Ndërsa, ndjekja e krerëve të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, si dhe udhëheqësit e Komitetit “Besa Kombëtare” të Prof. Ymer Berishës, si dhe grupeve të tjera veçsa shtojë. Prof Ymer Berisha, së bashku me Ukë Sadikun dhe me disa luftëtarë tjerë, ranë në pritë në Hereç të Gjakovës më 11 prill 1946, ku edhe u vra. Pritë të cilën e organizuan organet e sigurimit shtetëror jugosllav (OZN-a), si dhe të tradhëtuar nga bashkëpunëtori i sigurimit jugosllav, Rexhep Beka i Carrabregut, i cili e pagoi me kokë më vonë në Kongresin V të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare në malet e Blinajës.²⁰

Kurse disa ditë më parë u vra nga forcat partizano-çetnike, pikërisht më 1 prill 1946, Alush Smajli nga Llazica së bashku me vëllaun e tij Muratin dhe Ahmet Krajkun pas një rezistence disaorëshe në malet e Gjergjicës.²¹

Më 17 shkurt 1947 ndodhi përsëri tradhtia tjetër ku ranë në pritën e organizuar nga sigurimi shtetëror jugosllav në oborrin e Sakol Dinit të Sferkës së Gashit. U vranë Qazim Bajraktari i Astrozupit dhe Halil Sadria i Sferkës së Gashit dhe plagoset Ukë Sadiku, e pas pak dite u dorëzua te Mulla Syla në Mleqan, i cili e dorëzoi në gjykatën ushtarake, gjykatë, e cila Ukë Sadikun e dënoi me pushkatim. Prokurori i së cilës ishte Ali Osman Bunjakun.²² Shukria dhe u pushkatua më 1947 në Prishtinë, së bashku me Gjon Serreçin, Ajet Gërgurin etj.

Rekuizimi i pasurisë së patundshme në Malishevë e rrethinë gjatë viteve: 1945-1946

Duke u mbështetur në urdhëresën e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave dhe ai Mbrojtjes, me datë 18 mars, 1945 dok. tepër sekret nr.193/45, ndër të tjera thuhej: Konfiskoni drejtëpërdrejt nga populli bagëtinë e punës, bagëtinë për therje. T'i

¹⁹ Izber Hoti, *Forcat e Armatosura në Kosovë, Gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë - Prishtinë, 1998.

²⁰ Asllan Krasniqi, *Klina me rrethinë në valët e historisë*, Klinë, 2002, f. 41.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*.f.43.

merrni pajisjet punuese, kështu që organet shtetërore të marrin fuqinë e tyre punuese në mënyrë arbitrare, sipas veprave të tyre të kryera për tradhti ndaj shtetit jugosllav.

Por autoritetet ushtarake urdhëroheshin që të mos bënin çdo lloj konfiskimi të mallrave dhe produkteve, por t'i urdhëronin udhëheqësit lokalë dhe policinë e rendit që t'i zbatonin urdhrat. Kur autoritetet lokale dhe qeveria popullore e kishin të pamundur t'i zbatonin urdhrat, duhej të kërkonin ndihmë në organet dhe njësitë më të shpejta intervenuese, madje edhe ushtarake qofshin ato. Gjithashtu autoriteti ushtarak kishte të drejtë t'i urdhëronte autoritetet popullore dhe qeveritare për të zbatuar urdhrat për konfiskim.

Përveç saj personat ushtarakë, të cilët vepronin në kundërshtim të këtij urdhri do të bartinin përgjegjësinë më të madhe.

Urdhëresa ishte shpërndarë në të gjitha njësitë e të gjitha qendrat ushtarake përfshirë edhe ato të prapavijës.

Në bazë të kësaj urdhërese u bë konfiskimi i pasurisë së të gjithë veprimtarëve të së djathtës shqiptare, të gjithë atyre që luftuan për formimin e Shqipërisë etnike. Njësoj u trajtuan edhe përkrahësit e tyre, të cilët u përdoqën nga pushteti jugosllav, u burgosën, u maltretuan, u dënuan. Një pjesë bukur e madhe e tyre u pushkatuan pa gjyq. Udhëheqësit politiko-ushtarakë luftuan gjersa u vranë me armë në dorë, por nuk iu dorëzuan asnjëherë pushtuesve jugosllavë dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ata luftuan me partizano-çetnikët e që dolën të bashkuar në aradhat e tyre partizane në luftë kundër të gjithë patriotëve që luftuan për formimin e Shqipërisë etnike.

Ishte specifikuar, në rend të parë, konfiskimi i pasurisë armike si formë fillestare për zhvillimin e ekonomisë socialiste.

Në shkresën e Prokurorisë Publike të Qarkut të Prizrenit, dërguar Prokurorisë Publike të Kosovës dhe Metohisë, nr. konf. 10/46 dat. 28 mars 1946 Prizren, ndër të tjera thuhej se përmisimi i parregullsive të ligjeve mbi konfiskimin e pasurisë si dhe disa detaje të ligjeve të tjera janë zbatuar në opinion gabimisht e janë keqpërdorur te shtresa e mesme dhe e varfër.

1. Nëse ju e shihni se cili është dënuar me ligjin e luftës kundër spekulimeve të paligjshme dhe sabotazhit ekonomik, do të duhej të korrigjohet, gjë që janë goditur të gjitha shtresat, me ligjin e

konfiskimeve e fitimeve të luftës etj. pamë se këto ligje janë të rënda për shtresën e varfër.

2. Ligji për spekulime të paligjshme dhe sabotim ekonomik.

3. Ligji mbi konfiskimin e pasurisë së luftës.

1. Pastaj thuhej se ju keni parë se zbatimi i këtij ligji ishte përcjellur me parregullsi të ndryshme, kjo pjesërisht është duke u përpunuar dhe duhet të përfundojë brenda pak ditësh.

Çdo urdhëresë duhet të zbatohet me shpejtësi, kështu që, kjo ishte njëra ndër grackat serioze. Përveç saj ka një keqkuptim në udhëzimet e zbatuara me ligj. Duke zbatuar këtë akt në lidhje me klasat e mesme dhe ato të ulëta duhet të korrigjohet menjëherë.

a) Familjet e varfra nuk duhet të konfiskohen ,

b) Familjeve të shtresës së mesme gjatë konfiskimit duhet t'iu lihet produktet për ekzistencë,

c) Kurse në raste të tjera, vetëm atëherë kur bëhen shkelje të rënda të ligjit, duhet të bëhet rishqyrtimi.²³

Në bazë të këtij ligji për konfiskimin e pasurisë, pika 13 e tij, një numri të konsiderueshëm të familjeve shqiptare u konfiskohet pasuria e tundshme dhe e patundshme. Në shënjestër të pushtetit u gjendën familjet shqiptare, që u dalluan për veprimtari dhe luftë atdhetare gjatë viteve 1941-1944, apo kundër pushtimit serbo-jugosllav pas vitit 1944. Përmes konfiskimit të pasurisë së familjeve që u vlerësuan “si armiq të popullit”, krahas goditjes për t' i shkatërruar ato fizikisht, pushteti okupues kishte për qëllim që popullin shqiptar në Kosovë ta dobësonte ekonomikisht.

Të gjithë atyre familjeve shqiptare, që i kishin anëtarët e familjes në male dhe që luftonin kundër Jugosllavisë së Titos, iu konfiskohej pasuria e tyre.²⁴

Duke zbatuar politikë të padrejtë, qysh në vitet e para të pasluftës, pronarë tokash u bënë nëpunës të shumtë serbë e malazez, ndërsa u shpronësuan familjet shqiptare me autoritet, që konsideroheshin si kundërshtarë të socializmit dhe të pushtimit

²³ ASHK, *Fondi Prokuroria Publike Rrethi i Rahovecit*, kutia nr. 60.

²⁴ Mark Krasniqi, *Rrethanat politiko-shoqërore, më 1945-46 të rezistences nacionaliste shqiptare në Kosovë, E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike, Prizren-Klinë, 2006, f.30.*

jugosllav, si dhe të tjerë që në këtë apo atë mënyrë do të bëheshin kundërshtarë të ripushtuesve, apo të shërbëtorëve të tyre.²⁵

Ndër të tjera thuhej se detyrë e juaja është për të ndihmuar të gjitha organet e sigurimit jugosllav dhe të kryeni të gjitha detyrat që janë përcaktuar nga Republika Popullore e Serbisë. Sidomos kërkohet që t'i ndihmonin të gjitha organet e sigurimit shtetëror jugosllav kinse për të marrë gjithçka mbi baza ligjore. Dhe kërkohet që të krijohej autoritet pas procedurës. Duke siguruar shënimet e mësipërme sigurimi shtetëror jugosllav do ta vlerësonte kryetarin e qarkut dhe sigurimin e brendshëm²⁶. Me urdhër të Qeverisë Jugosllave, Prokuroria Publike e Republikës së Serbisë: do të thotë se organet e sigurimit shtetëror u inkuadruan edhe në masat e rekuizimit të drithërave.²⁷

Në këtë formë filloi menjëherë eksproprijimi i tokave të shqiptarëve, kundërshtarë të ripushtimit dhe të kinse kulakëve, kurse toka e tyre iu nda serbëve dhe malazezëve kolonë që filluan të ktheheshin sërish në Kosovë.

Jetën e shqiptarëve të pushtuar në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore e vështirësonin edhe rekuizimet e ndryshme, mbledhja kinse e tepricave, si dhe puna e dhunshme kinse vullnetare, por edhe forma të tjera të ndryshme të dhunës dhe të terrorit.²⁸

Kështu, siç e tregon populli, organet e pushtetit i detyronin që ditën të punonin e naten të shkonin në mbledhje të partisë, në të cilat shumë shqiptarë e pësonin, ngase nuk mund të përmbaheshin nga fjalimet demagogjike të komunistëve jugosllavë dhe të shërbëtorëve të tyre. Nga Prokuroria Publike Popullore e Serbisë, në dokumentin nr.konf. 57 datë 25.09.1946 njoftohet si në vijim:

Organet e Sigurimit Jugosllav morën urdhër për të marrë masa të rrepta kundër krahut të rezistencës shqiptare që ishin aktivë.

²⁵ Dr. Izber Hoti. *Orientime dhe qëndrime të shqiptarëve në Kosovë*, Shtëpia botuese, Faik Konica, Prishtinë, 2010. f.50

²⁶ ASHK, *Fondi Prokuroria Publike, e Rrethit të Rahovecit*, kutia nr.60.

²⁷ ASHK, *Fondi Prokuroria Publike, Rrethi i Rahovecit*, kutia nr. 60, vitet 1947-1953

²⁸ *Po aty*. f. 51.

Në një shkresë të bërë nga Prokurori Publik i Kosovës dhe Metohisë. nr. konf. 7-8/47 datës 18.01.1947. Në të cilën parqitet një raport me shënime të njerëzve të akuzuar. Ku thuhet se numri përgjithshëm i rasteve në kuadër të ligjit për krime kundër shtetit jugosllavë që janë regjistruar gjatë vitit 1946, janë 199 raste në regjistrat nga të cilët numri i të akuzuarve të krahut të nacionalizmit shqiptarë arriti deri në 190 me vepra penale të përfunduara. Çka do të thotë se shqiptarët tani paditeshin edhe nga kolonët të cilët ishin vendosur me anë të reformës agrare në tokat e pronarëve shqiptarë në kohën e mbretërisë serbe dhe asaj jugosllave me anë të ligjit agrar të vitit 1929 dhe të vitit 1931.

Të gjithë veprimtarët shqiptarë që luftuan kundër forcave partizano-çetnike jugosllave, luftëtarët e Ballit Kombëtar dhe të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, që vepronin në të gjitha teritoret shqiptare në Jugosllavi u shpallën armiq të shtetit jugosllav.

Këta luftëtarë ndiqeshin çdo ditë këmba këmbës nga forcat partizano-çetnike, e sidomos pas rezistencës së Drenicës gjatë dimrit 1944 -1945 dhe vrasjes së Tribunit Popullor Shaban Polluzhës dhe toger Mehmet Gradicës. Grupet e luftëtarëve të nacionalizmit shqiptarë u shpërndanë në të gjithë teritorin e Kosovës, ku bëheshin luftime të ashpra për jetë a vdekje, sepse tanimë u shuan shpresat për bashkim me Shqipërinë, pas vendosjes së pushtetit komunist në Shqipëri. Kurse këta luftëtarë nuk pranonin që t'i nënshtroheshin pushtetit jugosllav, por vendosën që të rezistonin deri në frymën e fundit për çlirimin e Kosovës. Udhëheqës dhe luftëtarë trima të Nacionalizmit Shqiptarë pati, si në të gjitha trevat tjera, edhe në Llapushë, e sidomos ndër udhëheqësit politik ishte Prof. Ymer Berisha, ndërsa ushtarakë ishin Ukë e Shaban Sadiku, Qazim Bajraktari, Alush Smajli etj., të cilët luftuan deri në momentin e fundit të jetës së tyre. Qeveria jugosllave nxori vendimin e 18 marsit 1945 me të cilin konfiskohej pasuria e të gjithë atyre që konsideroheshin armiq të shtetit. Në Kosovë u konsideruan shumë si të tillë, por njëkohësisht një numër i madh i takonte territorit të Llapushës si dhe fshatrave të Komunës së Malishevës, të cilëve, krahas dënimit me pushkatim, iu konfiskua edhe pasuria. Në konfiskimet që u bënë u mor çdo gjë nga pasuria e tyre, duke filluar nga pronat e paluajtshme, shtëpitë, gjëja e gjallë, shtroja e mbuloja, gjëra

elementare të familjes, e deri te gjërat ushqimore. Njëkohësisht familjet e tyre u internuan.

LISTA E PERSONAVE TË SHPALLUR ARMIQ TË SHTETIT DHE TË DËNUAR ME PUSHKATIM NË VITET 1945 - 1946 NË FSHATRA E MALISHEVËS SI DHE KONFISKIMI I PASURISË SË TYRE

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nr.i lëndës	Numri i anëtarëve të familjes	Prona e konfiskuar	Pasuria tjetër	Vlera e pasurisë në konfiskim në dinar
1.	Alush Smail Javori	Llaziçë	19/46	6	6.40 ha	1 shtëpi, 1 hambar, 2 pjata, 1 gotë bronzi, 1 pjatë bakri, 1 saç, enë, shtrorje e mbulojë, 8 dele, të gjitha kafshët e trasha e gjësende tjera.	41.850 din.
2.	Amrush Jetullah Javori	Llaziçë	18/46	%	0.80 ha	1 shtëpi banimi	4.600 din.
3.	Mehmet Januz Foniqi	Llaziçë	24/46	9	3.20 ha	Shtëpi, 1 hambar, 1 ka, 1 lopë, 1 mëshjtjerrë, 1viç, 10 dele, 3 pula, 1 sajë, 1 parmendë, 1 shat, 1 sëpatë, 2 kmesa, 1 kosë, 2 drapra, 1 gjysmësheke	38.718 din.

KONFISKIMI I PASURIVE TË SHQIPTARËVE NGA MALISHEVA ME RRETHINË...

						, 1 tepsi, 1 saç, 2 jorganë, 2 dyshekë, 2 jastëkë, 1 cergë, 1 thes, 300 kg misër, 30 kg grurë.	
4.	Sadik Imr Halili	Mleqan	21/46	8	10.74 ha	1 shtëpi dydhomëshe , 1 dhomë, 1 kullë, 1 shtallë, 1 pleme, 1 kosh, 1 kerstin druri, 1 pllug, 1 stog talle, 1 sanë, 1 kashtë, 100 kg misër, 60 kg grurë, 10 kg miell gruri, 10 kg fasule, 2 tharëse të vogla, 2 lopë, 2 dema, 1 mëshjtjerrë, 1 pelë, 3 jorganë, 1 dyshek e disa gjëra të imta.	101.840 din.
5.	Kajtaz Ramadani	Kijevë	70/45	35	23,90	1 shtëpi banimi, 1 hambar drithrash, kafshë, shtrroje mbulojë dhe gjësende shtëpiake.	72.070 din.

6.	Qazim Alush Bajraktari	Astarzup	43/45	7	2,70	1 shtëpi katërdhomë she, 1 kuzhinë, 1 hambar, 1 kosh, 2 jorganë, 1 trazues qumështi, 1 komodë, 3 arka për rroba të gruas, 1 jastëk.	24.500 din.
7.	Ibrahim Isuf Elez Morina	Astrazup	42/45	24	14.20	1 shtëpi dykatëshe, 10 jorganë, 4 dyshekë, 2 qilima, 1 cergë, 9 arka të grave, 5 jastëkë, 4 enë bakri, 3 tepsia, 1 trazues qumështi, 2 saça, 3 hardhi rrushi.	16.880 din.
8.	Jahë Jahir Regjep Morina	Astrazup	44/45	5	2.50	1 shtëpi me dy hyrje, 1 kuzhinë, 1 shtallë, 1 dem, 1 lopë, 3 arka të grave, 2 batanije, 2 jastëkë, 1 dyshek, 2 jorganë, 1 saç, 1 trazuese qumështi.	32.990

KONFISKIMI I PASURIVE TË SHQIPTARËVE NGA MALISHEVA ME RRETHINË...

9.	Fazli Zeqir Miftar Paçarizi	Dragobil	41/45	20	10,40	1 Shtëpi dykatëshe, 1 pleme, 1 hambar drithrash, 1 kosh, 2 qe, 3 lopë, 2 pela, 8 dhi, 10 dele, 3 qilima, 6 jastëkë, 5 jorgana, 3 kazana, 3 tepsia, 3 fuçi druri 100 kg.	65.000 din.
10	Ahmet Zymer Asllan Morina	Asrazup	45/45	%	4.30	Shtëpi katërdhomë she, 1 pleme, 2 qe, 1 lopë, 5 jastëkë, 2 dyshekë, 3 jorgana, 1 çebe, tigan bakri, 1 qerre druri.	18.000 din.
11	Mustaf Shaban Veli Mazreki	Gurishtë	46/45	16	8.20	1 Shtëpi dykatëshe, 1 hambar, 1 kosh, 3 lopë, 2 qe, 10 dele, 10 dhi, 2 cerga, 2 jastëk, 5 jorgana, 3 tepsia, 1 saçë, 1 trazuese qumështi, 1 qilim, 6 arka të grave, 1 qerre druri, 1 makinë gruri.	Vlera nuk është e shenuar

12	Kadri Minush Krasniqi	Damanekë	18/46	17	22.10	1 shtëpi, 1 hambar drithërash, kafshë, shtrojë, mbulojë, gjësende shtëpiake, qerre dhe vegla, bujqësore etj.	107.113 din.
13	Ukë Bajram Shala	Damanekë	18/46	%	2 ha	1 hambar drithërash, kafshë, gjësende shtëpiake, shtrojë e mbulojë.	3.800 din.
14	Qerim Ali Limani	Javor-Banjë	51/45	6	9.10 ha	1 Shtëpi dykatëshe, 1 koshere bletë, 2 qilima, 2 jorganë, 2 Arka të rrobave, 1 shoshë, 1 sitë, 1 arkë.	65.000 din.
15	Rexhep Rifat Kafexholli	Bellanicë	49/45	15	11.70 ha	2 shtëpi banimi dykatëshe, 1 hambar, 3 kosha për misër, 2 arka të rrobave, 1 arkë 500 kg, 2 kosë, 2 cerga, 5 jorganë, 3 sexhade, 2 qilima, 3 dyshekë, 1 orë muri, 2	727250 din.

KONFISKIMI I PASURIVE TË SHQIPTARËVE NGA MALISHEVA ME RRETHINË...

						llampa, 4 lëkura, 1 bakall, 1 tavolinë, 2 saça, 3 tepsia, 1 legen e gjësende të tjera të imta.	
16	Zeqir Shaqiri Zogaj	Lladroc	48/45	%	84 ari	1 shtëpi dydhomëshe , 1 krevat druri, 1 trazues qumështi, 1 zinxhir, 1 llampë.	5.700 din.
17	Nezir Elez Islami	Senik	30/45	%	4,27 ha	1 shtëpi banimi, arë, livadh, pyje, gjësende shtëpiake etj.	42.600 din
18	Hamit Bislimi Buçaj.	Lladroc				Ekzekutohet pa gjyq, ishte epror ushtarak i forcave vullnetare.	

Të gjitha vendimet për konfiskimin e pasurisë u morën me urdhër të qeverisë jugosllave dhe të Komitetit Krahinor të Kosovës, si dhe u zbatuan nga Gjykata e Rrethit e Rahovecit dhe Asambleja e Rahovecit²⁹.

²⁹ Arkivi i Gjeodezisë Rahovec. *Fondi i Konfiskimeve, kutia nr.1,3,4,7*. nxjerrë më 18 gusht 2012 nga origjinali. E njëjta dosje gjendet edhe në Arkivin e Kosovës dhe një pjesë në Arkivin e Gjeodezisë në KK Malishevë.